

Aktivite mësimore përmes lojës për fëmijët e moshës 3 deri në 10 vjeç



Ndihmoni fëmijët të vazhdojnë të mësojnë në shtëpi

Me mbylljen e përkohshme të shkollave dhe kopshteve, aktivitetet për mësim përmes lojës mund t'iu ndihmojnë fëmijëve të vazhdojnë të mësojnë nga shtëpia. Kjo listë e aktiviteteve ofron mundësi për lojë mësim, shprehje kreative, madje dhe ajo që është më me rëndësi, mundëson të kaloni kohë cilësore mes jush dhe fëmijëve tuaj.

Materialet janë të përshtatura nga aktivitetet, të cilat edukatorët anekënd shtetit i kanë përgatitur për ueb platformën nacionale për arsim, e cila përgatitet në kuadër të iniciativës Inno4Edu “Krijim të mjedisit për mësim cilësor dhe mësim përmes sajimit të përbashkët dhe inovacioneve”.

Ueb platforma, e cila për momentin është në proces e sipër, do të jetë vend ku arsimtarët klasorë, edukatorët dhe prindërit do të mund të gjejnë materiale dhe inspirime për zbatim më të lehtë të orëve, për implementim të mënyrave të reja të mësimit përmes lojës dhe vegla kreative për nxitje të zhvillimit socio-emocional të fëmijëve të moshës 3 deri në 8 vjeç. Platforma në fjalë do të ofrojë mundësi për të gjithë edukatorët kreativë të kontribuojnë në dobi të bashkësisë përmes shkëmbimit të praktikave, ideve dhe aktiviteteve të tyre më të mira.

https://www.youtube.com/watch?v=Kn_G6zN83_0&list=PLq9rh5ITnBpFtJYQ82dj2qqO7YkOkq0DW

Pasqyra e lumtur: Aktivitet për kushte shtëpiake dedikuar mësimit të formave matematikore (rrethit, katrorit dhe trekëndëshit). Aktiviteti në fjalë iu ndihmon fëmijëve të moshës 4 deri në 6 vjeç të zhvillojnë shkathtësi të qëndrueshmërisë, vërejtjes dhe fokusimit. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [maqedonase](#) dhe atë [shqipe](#).



Bingo: Aktivitet me kartela për fëmijët e moshës nga 4 deri në 6 vjeç për nxitje të qëndrueshmërisë gjatë procesit të mësimit dhe zbulimit. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [maqedonase](#) dhe atë [shqipe](#).

<https://youtu.be/5sStfD8sDME>

Forma të hareshme: Përmes lojës së përpunimit të formave gjeometrike, ky aktivitet do t'iu ndihmojë fëmijëve të moshës 4 deri në 6 vjeç, ta zhvillojnë vetëbesimin si dhe do t'iu ndihmojë t'i dallojnë, njohin dhe emërtojnë rrethin, katrorin, trekëndëshin dhe kënddrejtin. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [magedonase](#) dhe atë [shqipe](#).

<https://youtu.be/0dQrNrOzaKQ>

Rrota e gëzuar: Lojë interaktive për fëmijët e moshës 4 deri në 6 vjeç përmes së cilës ata e ushtrojnë qëndrueshmërinë dhe i mësojnë radhitjet sipas formës, ngjyrës dhe madhësisë. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [magedonase](#) dhe atë [shqipe](#).



Yjet dhe numrat: Lojë dedikuar fëmijëve të moshës 4 deri në 6 vjeç, në të cilën mund të përfshihen edhe anëtarë tjerë të familjes. Përmes këtij aktiviteti fëmijët e mësojnë nocionin për sasinë dhe e zhvillojnë qëndrueshmërinë. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [magedonase](#) dhe atë [shqipe](#).



Kompasi: Përmes kësaj loje fëmijët e moshës 8 deri në 10 vjeç nxiten të përdorin emra, mbiemra, folje dhe numërorë si dhe ta fuqizojnë vetëbesimin e tyre. Në lojë mund të përfshihen edhe anëtarët tjerë të familjes. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [magedonase](#) dhe atë [shqipe](#).




Përziejme ngjyra: Ky aktivitet për fëmijë të moshës 4 deri në 6 vjeç përbëhet nga përzierja e ngjyrave, nga të cilat fitohen ngjyra sekondare. Loja e ka për qëllim ta nxisë fëmijën, ta zbatojë aktivitetin deri në fund dhe ta përvetësojë shkathtësinë e qëndrueshmërisë deri në fund të procesit të mësimit dhe zbulimit. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [magedonase](#) dhe atë [shqipe](#).



Përralla ime magnetike: Ky aktivitet iu dedikohet fëmijëve të moshës 4 deri në 6 vjeç dhe përbëhet nga përpilimi i përrallës me përdorim të shablloneve të personazheve të përrallës. Loja në fjalë e nxit fantazinë e fëmijës përmes krijimit të ideve të reja dhe zgjidhjeve origjinale. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [maqedonase](#) dhe atë [shqipe](#).



Matematika me fruta: Aktivitet për fëmijë të moshës 6 deri në 8 vjeç i cili mundëson zbatim të strategjive për përlogaritje dhe zgjidhje të problemeve matematikore. Ai ndihmon në zhvillimin e vetëbesimit dhe e nxit kureshtjen. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [maqedonase](#) dhe atë [shqipe](#).



Nga shkronja deri në fjalë: Përmes përpilimit të fjalëve sipas fotografisë së caktuar, fëmijët e moshës 6 deri në 8 vjeç mësojnë t'i radhin drejt shkronjat në fjalë. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [maqedonase](#) dhe atë [shqipe](#).

<https://youtu.be/Pc7GZoqAznE>

Bëjmë akulllore: Përmes krijimit të kutive për akulllore dhe vënies së topave me ngjyrë të caktuar në to, fëmijët e moshës 3 deri në 6 vjeç e zhvillojnë aftësinë për gjetje të qasjeve personale në zgjidhjen e situatave problematike. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [maqedonase](#) dhe atë [shqipe](#).



Dalloni emocionet: Përmes prerjes dhe ngjitjes së emotikonëve të ndryshëm fëmija mëson t'i dallojë emocionet sipas imazhit të dhënë. Kjo lojë iu dedikohet fëmijëve të moshës 4 deri në 6 vjeç. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [maqedonase](#) dhe atë [shqipe](#).



Tregimi për vezën lozonjare: Ky aktivitet iu dedikohet fëmijëve të moshës 3 deri në 6 vjeç dhe përbëhet nga loja për kapje dhe hedhje të merimangës. Aktiviteti në fjalë i ndihmon fëmijës t'i zhvillojë cilësitë e qëndrueshmërisë dhe kureshtjes. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [maqedonase](#) dhe atë [shqipe](#).



Rebusi lozonjar: Fëmijët e moshës 6 deri në 8 vjeç përmes kësaj loje do të mund të aftësohen për zbatim të operacioneve matematikore të shumëzimit, pjesëtimit, mbledhjes dhe zbritjes. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [maqedonase](#) dhe atë [shqipe](#).



Format lozonjare: Për fëmijët e moshës 4 deri në 6 vjeç. Loja ka për qëllim ta nxis fëmijën t'i dallojë dhe t'i emërtojë format gjeometrike dhe ngjyrat. Shkarkoni udhëzimet për lojë dhe shtojcat në gjuhën [maqedonase](#) dhe atë [shqipe](#).

Inno4Edu është iniciativë e UNICEF-it e financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës së Britanisë në Shkup, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Byronë për Zhvillim të Arsimit, e implementuar nga SmartAp - Laboratori për inovacione sociale.